




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 654/18
655/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjez. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković-Anëtar, duke vendosur sipas ankesave së parashtruara nga operatorët ekonomik “NNT Eing Com” – Podujevë dhe “Alfa.i” Sh.p.k – Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Rexha Sh.p.k” – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria”, me numër të prokurimit: “616/18/2602/511” të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më datën 18.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesate operatorëve ekonomik “NNT Eing Com” – Podujevë dhe “Alfa.i” Sh.p.k – Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria”, me numër të prokurimit: “616/18/2602/511”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria”, me numër të prokurimit: “616/18/2602/511”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues“NNT Eing Com” – Podujevë dhe “Alfa.i” Sh.p.k – Lipjan, aprovohen pjesërisht si të bazuara, ju bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesave.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:26.04.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt:06.06.2018

Data e njoftimit me letër standarde për OE “NNT Eing Com” – Podujevë: 29.10.2018.

Data e njoftimit me letër standarde për OE “Alfa.i” Sh.p.k – Lipjan: 19.07.2018.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik“NNT Eing Com” – Podujevë me dt: 23.07.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 26.07.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “NNT Eing Com” – Podujevë si të pa bazuar.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “Alfa.i” Sh.p.k – Lipjan me dt: 02.11.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 06.11.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE:“Alfa.i” Sh.p.k – Lipjan si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “NNT Eing Com” – Podujevë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me14.11.2018me nr. 654/18,kundër njoftimitpër dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria”, me numër të prokurimit: “616/18/2602/511”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 69të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe 41 të RRUOPP.

Operatori ekonomik ankues “Alfa.i” Sh.p.k – Lipjan si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 14.11.2018me nr. 655/18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria”, me numër të prokurimit: “616/18/2602/511”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.11.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:26.11.2018, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues “NNT Eing Com” – Podujevë dhe OE “Alfa.i” Sh.p.k – Lipjan në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenin 4 pika 1.37 të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron se kjo ky pretendim i OE ankues nuk ka ke te beje me çështjen e ngritur nga OE apo ndoshta OE ka ngatërruar piken e ngritur nga ky nen, si dhe duke mos e sqaruar ne deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet lidhur e këtë pretendim te ngritur neni 4 pika 1.37 po citoj: “Procedurë e hapur - procedurat e prokurimit që i lejojnë çdo operatori të interesuar ekonomik të paraqet tender”. Prandaj, pretendimi i palës ne ankese ne këtë pikë është i pa qëndrueshëm. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka rekomanduar për dhënie te kontratës OE i cili ka prezantuar ne ofertën e tij Menaxherin e Punishtes z. Dijamant Kabashi, nuk është ofruar letër referenca siç kërkohet ne FDT. Po ashtu te njëjtit i mungon përvoja e punës si Menaxher/Udhëheqës i punishtes/ndërtimit pasi qe ne CV-ne e tij është paraqitur eksperiencë vetëm ne fushën e projektimit/mbikëqyrjes te projekteve dhe jo ne ekzekutimin e tyre. Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin, eksperti shqyrtues sqaron,se OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar z. Dijamant Kabashin ne cilësinë e Projekt Menaxherit te Punimeve, për këtë projekt, Diploma Inxh. i dip. i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv i cili ka diplomuar me date 20 Tetor 2005, CV (Eksperienca profesionale e prezantuar ne CV për Projekt Menaxherin e Punimeve në fjalë, ne pjesën më të madhe te prezantuar përvojën nen fushën e projektimit dhe dizajnimit, mirëpo ka edhe projekte te mbikëqyrjes se punimeve ne cilësinë e projekt menaxherit te kësaj fushe, andaj e plotëson kërkesën e AK ne FDT me 3 vite përvojë pune pas diplomimit) dhe Kontrate mbi Vepër për këtë Aktivitet te Prokurimit me

numër dhe titull, të nënshkruar me datë 06.06.2018, kurse referencat nga punëdhënësi i mungojnë nuk ka prezantuar fare në ofertën e tij OE i rekomanduar për kontratë dhe nuk e ka plotësuar kërkesën e AK lidhur me dëshmitë të kërkuar në FDT pika 9.2 - Dëshmitë mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pasi mungojnë referencat për menaxherin e projektit të punimeve në fjalë. Eksperti shqyrtues bazuar në këto fakte sqaron si në vijim: Kërkesat për sqarime shtesë në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-se, është kompetencë dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të kërkojë sqarime me shkrim nga tenderuesit mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tyre, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve apo të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda afatit ligjor të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla të bëhen në përputhje të plote me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Prandaj, në bazë të analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimet e palës në ankesë në këtë pikë janë të qëndrueshme. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE i cili nuk ka plotësuar Kriteret sipas kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 dhe 9.2 pika nr. 3 ku kërkohet një inxhinier ose Bachelor të Bujqësisë ndërsa kompania Rexha shpk ka ofruar një Bachelor të Blegtorisë i cili nuk kualifikohet për tenderin në fjalë pasi nuk ka të bëjë me lëmin përkatëse. Duke u bazuar në fakte të prezantuara në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim dhe analizim, eksperti shqyrtues sqaron, se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar z. Besim Jonuzaj në cilësinë e Bachelorit të Bujqësisë, i cili ka diplomuar me datë 30 Mars 2015 në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë (Nuk është kërkuar ndonjë drejtimi i Fakultetit të Bujqësisë, prandaj konsideroj se plotëson kërkesën e AK), Kontratë mbi vepër të lidhur me datë 06.06.2018. Mirëpo në CV të prezantuar për personin në fjalë, puna e tanishme: 01/03/2017 – Vazhdon, nuk e plotëson kërkesën e AK, 2 vite përvojë pune pas diplomimit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nën 9.1 pika 3 e FDT, gjithashtu në CV nuk jepen detaje se për cilën kompani punon apo ka përvojë përveç tek përshkrimi po citoj: “Udhëheqja dhe projektimi i një varg projektesh të cilat kompania jone i ka realizuar” janë disa projekte të ndryshme që kanë vetëm titull dhe vlerë të kontratës, por nuk dihet se në çfarë pozite apo cilësie apo për cilin kompani apo AK ka qenë i angazhuar në këto projekte. Duke u bazuar në fakte të prezantuara në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, eksperti shqyrtues sqaron, në bazë të analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë qëndron, pasi AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së si dhe RRUOPP nën 39.8 po citoj: CV të dorëzuar nuk përmbush kërkesat, Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka plotësuar Kriteret sipas kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 dhe 9.2 pika nr. 5 për inxhinierin e Energjetikës ka ofruar z. Luljeta BABUNI dhe z. Berat HASANAJ me përvojë të njëjtë të punës. Konsiderojmë se për një projekt në baze të praktikës asnjëherë nuk janë angazhuar

dy inxhinier te energjetikes, pra OE pretendues si fitues ka kopjuar përvojën e punës se përshkruar tek te dy inxhinieret dhe është e dyshimtë se përvoja e cilit inxhinier është reale. Te njëjtit kane përvojë vetëm ne projektim te projekteve dhe jo ne ekzekutim te tyre. Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim dhe analizim, eksperti shqyrtues sqaron,se OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar z. Luljeta Babuni, ne cilësinë Inxh. i Dip. i Elektronikes, si dhe z. Berat Hasanaj, ne cilësinë e Bach. i Inxhinierisë Elektrike, me Kontrata mbi vepër te nënshkruara me date 06.06.2018, CV e tyre kane formatin/formën e njëjtë. CV e z. Luljeta Babuni tek puna e tanishme: 01/03/2013 – vazhdon, nuk jep detaj për punëdhënësin, kurse tek përshkrimi po citoj: “Udhëheqja dhe projektimi i një varg projektesh te cilat kompania jone i ka realizuar”(cila kompania kur nuk ka te dhëna për cilën kompania punon), janë disa projekte te ndryshme qe kanë vetëm titull dhe vlere te kontratës por nuk dihet se ne çfarë pozite apo cilësi apo për ciline kompani apo AK, ka qenë i angazhuar ne këto projekte te prezantuara me CV e saj. Ndërsa, CV-ja për z. Berat Hasanaj tek puna e tanishme: 01/08/2012 – vazhdon, nuk jep detaj për punëdhënësin, kurse tek përshkrimi po citoj: “Udhëheqja dhe projektimi i një vragë projektesh te cilat kompania jone i ka realizuar” janë disa projekte te ndryshme qe kanë vetëm titull dhe vlere te kontratës por nuk dihet se ne çfarë pozite apo cilësie apo për ciline kompani apo AK, ka qenë i angazhuar ne këto projekte te prezantuara në CV e tij. Eksperti shqyrtues bazuar ne këto fakte sqaron si ne vijim: Kërkesat për sqarime shtesë ne bazë të nenit 59 dhe 72 te LPP-se, është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te ofertave te kërkoj sqarime me shkrim nga tenderuesit mbi cilindo nga aspektet e tenderit te tyre, ne mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve apo të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda afatit ligjore te caktuar kohor, me kusht qe kërkesat e tilla te bëhen ne përputhje te plote me parimet e trajtimit te barabarte dhe transparencës. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimet e palës ne ankese ne këtë pike janë te këtë pike është pjesërisht e qëndrueshëm. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka plotësuar kërkesën nr. 13 sipas te cilës kërkohet Certifikata e origjinës dhe Fitosanitarisë për fidanët qe i plotëson standardet e BE-se, por ka prezantuar vetëm Dokumentacionin e Biznesit te Fidanishtja Parku shpk qe do te thotë nuk i ka përmbushur kërkesat e FDT (mungojnë Certifikata e Origjinës dhe Fitosanitarisë).Duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar si dhe duke e marre parasysh Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 dhe 9.2 Te FDT pika 13, Kërkesa: OE duhet te dorëzojë certifikate te origjinës dhe fitosanitare për fidane qe i plotëson standardet e BE-se, Dëshmia: Kopje e certifikate se origjinës dhe kopje e certifikatës fitosanitare.Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, eksperti shqyrtues sqaron, se OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar ne ofertën tij “Certifikate fitosanitare e brendshme” me date 11/11/2017 dhe No. CFB05431/2017, e lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dheVeterinarisë ne emër te kompanisë “Fidanishtja

Parku” Shpk, Koretin, Kamenice, si dhe ka prezantuar “Marrëveshje Bashkëpunimi” me këtë OE ne fjale me date 06.06.2018 dhe tek Vlefshmëria e Marrëveshjes se Bashkëpunimit shkruan po citoj: “Kjo marrëveshje Bashkëpunimi është e një natyre tërësisht rekomanduese. Ajo nuk krijon detyrime ligjore për palët nënshkruese” po ashtu ne këtë marrëveshje askund nuk cekte se është për këtë aktivitet te prokurimit, numrin apo titullin e prokurimit. Mirëpo, pas sqarimeve te kërkuara nga komisioni i vlerësimit përmes Letrës Standarde për Sqarimin e Tenderit me datë 05.09.2018, po citoj: “Keni dorëzuar nga nenkontraktori një certifikatë vendore te fitosanitarise, por nuk keni dorëzuar dëshmi për prodhim dhe plasim te fidanëve sipas certifikatës se prezantuar” OE i rekomanduar për kontrate jap përgjigje përmes e-mail, bashkëngjitë edhe një “Certifikate Sanitare te brendshme me Nr. 0000102 me date 06.02.2017 e cila është ne emër te “Fidanishtja Parku” Shpk, Koretin, Kamenice, leshur nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Eksperti shqyrtues bazuar ne këto fakte sqaron si ne vijim: Kërkesat për sqarime shtesë ne bazë të nenit 59 dhe 72 te LPP-se, është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te ofertave te kërkoj sqarime me shkrim nga tenderuesit mbi cilindo nga aspektet e tenderit te tyre, ne mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve apo të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda afatit ligjore te caktuar kohor, me kusht qe kërkesat e tilla te bëhen ne përputhje te plote me parimet e trajtimit te barabarte dhe transparencës. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimet e palës ne ankese ne këtë pike janë pjesërisht të qëndrueshëm. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka plotësuar kërkesën nr. 7 ne FDT me saktësisht nuk i ka respektuar kërkesat e me poshtme: Kamion Kiper, tabela 01-473-CJ, ka m³ me te vogël se 10m³ (është <10m³); Cilindri BOMAG kapaciteti i tij është 12100 kg d.m.th. është 12.1 T (është <13T); Eskavator i blere tek NSH “Te Gazi” nuk është i shënuar kapaciteti, ne dosje është kërkuar (0.4 – 1.0m³); Ngarkuesi LIEBHER L564 kapaciteti i këtij mjeti mungon, por pas një analize shihet se kapaciteti i këtij mjeti është 4 m³, më e lartë se sa kërkesa e AK në FDT, (1 – 1.5m³); Ngarkuesi Komatsu PC 450LC-6, nr. shasisë: K34086, kapaciteti i këtij mjeti mungon por pas një analize kapaciteti është 1.3m³, më e lartë se sa kërkesa e AK ne FDT, (0.4 – 1.10m³); Ngarkuesi LIBHER L574, kapaciteti i këtij mjeti mungon, por pas një analize shihet se kapaciteti i këtij mjeti është 4.5 m³, me e larte se sa kërkesa e AK ne FDT, (1 – 1.5m³); Duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar si dhe duke e marre parasysh Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 dhe 9.2 te FDT pika 7, Eksperti Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një liste te pajisjeve te nënshkruar dhe vulosur si dhe një marrëveshje për makineri me kompaninë “Bemita Company” Shpk, po citoj: “Kjo marrëveshje vlen për te gjitha projektet gjate vitit 2018” (nuk është cekur për këtë projekt) e cila është nënshkruar me date 28.05.2018. Nga te gjitha këto dhe duke pasur parasysh se edhe komisioni i vlerësimit e po ashtu edhe komisioni i Ri-vlerësimit kanë kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontrate për sqarimin e pajisjeve te prezantuar (disa here), sepse

nuk janë specifikuar ashtu si është kërkuar në FDT, poashtu edhe eksperti shqyrtues e ka te pamundur te vërtetoj apo te konstatoj se OE i rekomanduar për kontrate plotëson apo nuk plotëson kërkesën e AK ne këtë pike duke u bazuar ne dërhemit e prezantuar nga OE ne ofertën tij. Eksperti shqyrtues sqaron se komisioni i ri-vlerësimit gjate punës se tij ne këtë aktivitet te prokurimit lidhur me pajisjet e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë pas disa sqarimeve ka vendosur te bëjë një vizitë ne vend punishten e OE për te vërtetuar pajisjet/mjetet e OE, se i plotëson apo nuk i plotëson sipas kërkesave ne FDT, Mirëpo komisioni i ri-vlerësimit gjate vizitës ne vend punishten e OE nuk ka mbajtur një proces verbal lidhur me pajisjet te cilat i posedon OE i rekomanduar për kontrate dhe te vërtetoj se OE i plotëson kërkesat e AK ne FDT, prandaj ky komision nuk ka respektuar nenin 7 par. 1 dhe par.2 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik” si dhe nenin 55 par. 2 të LPP-së, po citoj: “(ii) komunikimet gojore bëhen në publik dhe në mënyrë transparente, dhe (iii) menjëherë pas komunikimit të tillë gojor, autoriteti kontraktues përgatit një përmbledhje të të gjitha aspekteve materiale të komunikimit të tillë dhe të njëjtin ua dërgon apo e vë në dispozicion për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik”.Duke u bazuar ne këto fakte dhe argumente eksperti shqyrtues sqaron se AK – komisioni i ri-vlerësimit sa here qe paraqitet nevoja te komunikoj me goje (dhe jo me shkrim – ne letër, me faks dhe ose ne mënyrë elektronike), është i obliguar te mbaje një proces verbal – një raport te detajuar ne mënyrë qe te respektohen qëllimi dhe parimet kryesore te prokurimit, mirëpo ne rastin konkret komisioni i ri-vlerësimit gjate vizitës ne vend punishten e OE te rekomanduar për kontrate nuk ka mbajtur proces verbal fare, gjithashtu ky komision nuk ka respektuar nenin 59 par. 3 te LPP-se po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme vlerësoj se pretendimet e palës ne ankese ne këtë pike janë qëndrueshëme.Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit te pretendimeve ankimore te parashtruara ne ankese nga OE ankues, sqaron se ky aktivitet i prokurimit duhet te rivlerësohetdhe njëherit rekomandoj AK-se qe edhe një here ta bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1,

dhe AK te respektoj ne tërësi dispozitat ligjore te LPP-se lidhur me këtë aktivitet te prokurimit konform njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit. Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, rekomandojmë që ankesat e OE-ve: N.N.T. “Eing Com”– Podujevë, dhe “Alfa.i” Sh.p.k. – Lipjan, për tenderin e AK: KK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria” me nr. të prokurimit: 616-18-2602-5-1-1, të aprovohen të bazuara (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin më lartë), dhe të njëjtin tender rekomandojmë Autoritetin Kontraktues, që ky aktivitet i prokurimit të RI-VLËRESOHT dhe të respektohen në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së.

Operatori Ekonomik ankues “NNT Eing Com” – Podujevë, përmes parashtresës me shkrim të datës:29.11.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik ankues “Alfa.i” Sh.p.k – Lipjan, përmes parashtresës me shkrim të datës: 17.12.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 29.12.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.12.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesit e operatorëve ekonomik ankues, eksperti shqyrtues profesional, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Podvorica deklaroi: “Ne jemi pajtuar pjesërisht me mendimin e ekspertit edhe pse prej 5 pretendimeve ankimore, vetëm 3 janë të bazuara, sa i përket pretendimit ankimor për pajisjen traktor desha të shtoj se edhe me ligjin për automjete dhe sipas udhëzuesit administrativ për regjistrim të automjeteve traktori duhet të regjistrohet të ketë targa dhe librezë gjatë fazës së ofertimit është kërkuar sqarime lidhur me pajisjet e traktorit e që AK është përgjegjbur se pajisje përcjellëse duhet të jenë plugu, freza dhe pijatorja. Kështu që OE i rekomanduar ka dështuar të plotësoj kërkesën, sa i përket pretendimit ankimor lidhur me cisternë është kërkuar që kapaciteti i saj të jetë 2500 litra ndërsa OE ka ofruar cisternë për bartje të derivateve të cilën kërkesë e ka sqaruar edhe eksperti dhe desha të shtoj se nuk është njejt sepse ajo është e dedikuar për derivate e jo për ujitje, projekti është i tjetër natyre. Edhe te pika tjetër ankimore sa i përket komunikimeve në mes AK dhe OE të rekomanduar ku është kërkuar gjatë fazës së

rivlerësimi janë kërkuar sqarime drejtuar OE përmes e-mailo zyrtar të regjistruar në e-prokurim ku edhe pas afatit për përgjigje në këto sqarime OE- nuk ka dhënë as një sqarim AK- në vend që ta shpall si të pa përgjegjshëm kërkon sqarime në njëe-mail tjetër i cili nuk ka qenë e-mail zyrtar. Desha të cek se i njëjti AK para një muaj neve na ka eliminuar nga një procedurë tjetër për të vetmen arsye që nuk kemi ofruar dud doganor për pajisjen fisnisher, andaj kërkoj nga paneli që kërkesën ta aprovoj dhe lënda të kthehet në rivlerësim”.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE: “Alfa.i” z. Zeqiri Deklaroi: “Fillimisht ne si komani pajtohem me mendimin e ekspertit, gjithashtu theksoj se qëndrojmë prapa secilit pretendim ankimor të parashtruar në OSHP. AK- fillimisht ka kërkuar sqarim për makineri të cilën ne e kemi ofruar dhe AK e ka pranuar dhe ka deklaruar se makineria jonë përputh kushtet e kërkuara. Kurse për referenca ka kërkuar sqarim ku edhe tënjëjtin ja kemi ofruar AK-së. Për pretendimet tona të parashtruara ne si OE- pajtohem me ekspertin i cili ka deklaruar se pikat tona janë te qëndrueshme. Me datën 29.10.2018 nga AK KEMI pranuar letrën për eliminim ku thuhet se ne nuk kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme se plotëson kërkesat dhe sipas FDT-së respektivisht për kryerjen e punëve të ngjashme në vlerën e kërkuar, ne si OE- deklarojmë se me bindje të plotë se kemi përmbushur të gjitha kërkesat nga AK dhe dëshmitë tona sipas kërkesës për sqarim kemi bashkangjitur përmes e-mail ku në të është paramana me pozicione të hijezuara, email ky që është dërguar me datën 07.09.2018 dëshmi që nuk janë marr për bazë nga AK. Kërkojë që lënda të kthehet në rivlerësim”.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Bardhaj deklaroi: “Realisht ne kemi deklaruar se nuk pajtohem me mendimin e ekspertit që lënda të kthehet në rivlerësim dhe këtu do të kisha dhënë përgjigjet e dy OE që kanë paraqitur ankesë, lidhur me pretendimin e parë të cilin e ka arsyetuar eksperti dua të shtoj se një komision ka vizituar dy OE ankues OE të rekomanduar dhe unë i besoj këtij konstatimi lidhur me pretendimin dy dhe pretendimin e OE ankues për pajisjen traktor, dua të përkujtoj se si dëshmi janë kërkuar deklarata libreza marrëveshje për pajisjen ose shfrytëzimin e tij për pronësi dhe faktuar e cila është dorëzuar për këtë pajisje shënon se është traktor me të gjitha pajisjet dhe që ajo faktuar e mbulon marrëveshjen për blerje të pajisjes. Për të dëshmuar këtë sqaroj se ky panel i nderuar ne një vendim për një aktivitet tjetër respektivisht për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve na ka rekomanduar që të pranohen edhe dëshmi tjera e jo vetëm deklarata doganore sepse kjo mund të jetë kufizuese për konkurrencën. Lidhur me pretendimin tjetër për një certifikatë sanitare e cila kontestohet e të cilën eksperti e konstaton si pretendim të qëndrueshëm duke u bazuar në faktin se marrëveshje nuk është bërë për aktivitetin konkret, sqaroj se nuk ka pas kërkesë për atë marrëveshje. Në përgjigjet 4 dhe 5 pajtohem, ndërsa në përgjigje nr 6 që e potencoj edhe ankuesi ju sqaroj se OE i rekomanduar ka njoftuar para këtij aktiviteti se adresa zyrtare ekzistuese nuk funksionon dhe se ka adresën e re elektronike për kontakt zyrtar, pra edhe komunikimet e komisionit të vlerësimit me këtë OE janë

zhvilluar në këtë adresë, mirëpo në mungesë të zyrtares e cila e ka menaxhuar këtë, një zyrtar tjetër e ka dërguar kërkesën në adresën e më parme e cila nuk funksionon duke e vërejtur këtë kamë konstatuar se gabimi është bërë nga zyrtarët dhe OE nuk është fajtor dhe kam kërkuar që të përsëritet edhe një herë shkresa në adresën të cilën vet OE e ka paraqitur si kontakt zyrtar. Kjo është bërë me arsyen e thjeshtë se për shkak të gabimit të ndonjë zyrtari nuk duhet të pësojë asnjë OE në aktivitet. Lidhur me pretendimet ankimore të Alfa i deklaroi se ky OE nuk është palë e interesit për faktin se tenderi i tij është refuzuar dhe i njëjti nuk e ka kontestuar eliminimin por ka marr hapa drejt ankesës e që sipas meje hapin e parë është dashtë ta marr për arsyetimin e tenderit të vet e jo të shfaq pretendime për OE tjerë. Kërkoj të ankesa të refuzohet dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK”.

Gjatë prezantimit në seance Eksperti shqyrtues z.Beqiri deklaroi: “Nuk kam diçka më shumë se që unë kam jap në ekspertizë, AK fakt që parashtruar kërkesa të pa qarta dhe kjo është e vështirë të sqaroj, mirëpo nëçdo pretendim kam sqaruar”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor konstatoj se pretendimi i OE ankues se AK ka shkelur nenin 4 pika 1.37 të LPP-së është i paqëndrueshëm dhe nuk ka të bëjë me çështjen e ngritur për faktin se neni 4 pika 1.37: “Procedurë e hapur - procedurat e prokurimit që i lejojnë çdo operatori të interesuar ekonomik të paraqet tender”, prandaj, paneli shqyrtues konstaton se pretendimi i palës ne ankese ne këtë pikë është i pa qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues konstaton se është pjesërisht i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues lidhur me përvojën e punës dhe referencat e Inxh. Dijamant Kabashi, pasi që OE i rekomanduar për kontratë në bazë të dokumentacionit të lëndës ka dëshmuar se i njëjti plotëson kërkesën e AK ne FDT me 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka plotësuar kërkesën nr. 13 sipas të cilës kërkohet Certifikata e origjinës dhe Fitosanitarisë për fidanët, OE i rekomanduar pas sqarimeve shtesë të kërkuara nga autoriteti kontraktues në një përgjigje me email ka bërë të ditur dhe ka bashkëngjitur një “Certifikate Sanitare të brendshme me Nr. 0000102 me date 06.02.2017 e cila është në emër të “Fidanishtja Parku” Shpk, Koretin, Kamenice, leshur nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, andaj paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor i OE ankues, është i pa qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka

plotësuar kërkesat e DT lidhur me makinerinë e kërkuar, konstaton se si dëshmi janë kërkuar deklarata libreza marrëveshje për pajisjen ose shfrytëzimin e tij për pronësi dhe nga dokumentacioni i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë sipas faturës e cila është dorëzuar për këtë pajisje shënon se është traktor me te gjitha pajisjet dhe qe ajo faturë e mbulon marrëveshjen për blerje te pajisjes, andaj paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i paqëndrueshëm.

Paneli shqyrtues me rastin e vendosjes dhe vendimmarrjes lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë, mori parasysh edhe nenin 104 par. 4 pika (iii) të LPP-së, ku thuhet: *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (iii) të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Ne rastin konkret duke pasur për bazë (sipas llogaritjes se komisionit vlerësues te AK-së), se çmimi i OE parë ankues “Eing Com” është 445.710.00€, dhe çmimi i OE dytë ankues “Alfa-i” është 438.727.04€, ndërsa çmimi i OE të rekomanduar për kontratë “Rexha” sh.p.k është 362.878.72€, prandaj për panelin shqyrtues edhe nëse has në lëshime të vogla eventuale janë jo të rëndësishme në raport me interesisin publik dhe fondet publike, e për të cilat fonde dhe burime publike, autoritetet kontraktuese janë të obliguara ti përdorin në mënyrën më ekonomike.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues bazuar në shkresat e lëndës si dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë i plotëson të gjitha kërkesat parashtruara në dosje dhe oferta e tij në kuptim të nenit 6 të LPP-së, dhe është me e favorshme se sa OE ankues, ndërsa autoriteti kontraktues gjatë ri vlerësimit te këtij aktiviteti të prokurimit ju ka përmbajtur kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues konstaton se në rastin konkret AK-ja, ka respektuar nenin 1,6,7, 59 dhe 60 të LPP-së për faktin se ka trajtuar në mënyrë te barabartë te gjithë ofertuesit duke e rekomanduar për dhënie te kontratës operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe ka ofertuar me çmim më të lirë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –"Komuna e Prishtinës",
- 1x1 OE- "NNT Eing Com" – Podujevë
- 1x1 OE- "Alfa.i" Sh.p.k – Lipjan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.